

VENDIM
Nr.37, datë 27.1.1997

PËR PAGESËN E KUOTËS PËR RINDËRTIMIN E BOSNJË-HERCEGOVINËS

Në zbatim të detyrimeve të vendit tonë si anëtar i Organizatës së Konferencës Islamike, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të bëhet pagesa e kuotës që i përket vendit tonë në kuadrin e ndihmës që vendet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike kanë vendosur të japin për rindërtimin e Bosnjë-Hercegovinës, në masën 620 mijë lekë, që përballohet brenda buxhetit të vitit 1997 të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë që të përcaktojnë modalitetet përkatëse për plotësimin e këtij detyrimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi